



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2199/12 prot.,

Tiranë, më 17.09.2021

VENDIM  
Nr. 58, datë 17.09.2021

PËR

**NJË RREGULLIM NË VENDIMET NR.48 dhe NR. 50 DATË 23.12.2020.**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 51 të statutit të UMT-së , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë.” e ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit n-së ë një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar, si dhe në relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 380/6 prot, datë 31/05/2021 “Për një rregullim në vendimet e bordit nr.48 dhe nr.50 datë 23.12.2020” , Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Studenti Lumturi Loka, i cili studion në Fakultetin e Mjekësisë Dentare i shpallur jo fitues për përfitimin e bursës dhe përjashtimin nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2020-2021, me vendimet nr.40 dhe nr.50 datë 23.12.2020, **të shpallet fituese.**
2. Efekti financiar për këtë student në nevojë për përjashtimin nga tarifa e shkollimit është 45,000 (dyzet e pesëmijë) lekë, vlerë e cila do të pakësojë të ardhurat e UMT-së për vitin 2021.
3. Efekti financiar për këtë student në nevojë për përfitimin e bursës është 85,000 (tetëdhjetë e pesëmijë) lekë dhe përballohet nga fondet grant të buxhetit të shtetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Institucionit.

**KRYETARI**  
**Prof. Florian TOTI**



Punoi, konceptoi: Majlinda Fagu Përgjegjëse e Sektorit të Financës  
Miratoi: Besnik Çina Administrator i UMT-së.  
Numri i kopjeve 3(tre)  
Data e dorzimit: 17.09.2021

*Besnik Çina*

*M. Fagu*